ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	**210-25-4063-1-2-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për **"Blerja e doneve për dy parqet kombëtare, Parku Kombëtar Bjeshkët e Nemuna dhe Sharri".**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

GJEO-PROJEKT SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. UÇK p.n

(Adresa)

Rahovec ***21000***

(Vendi)(Kodi postar)

049 602 516 ***N/A***

(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)

Omer Çmega

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

gjeo.projekt@gmail.com

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

02.07.2025

[1]Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

Adresa e plotë)

_____

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

_____

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë:13.05.2025 Data e hapjes së ofertave: 03.06.2025 Njoftimi mbi vendimin e AK-së:13.06.2025. Kërkesa për Rishqyrtim:18.06.2025 Pergjigje ndaj kerkeses per Rishqyrtim:23.06.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji Nr.04/L-042 Për Prokurimin Publik te Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotesuar me Ligjhin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik.

*** Sipas Nenit 118të LPP, OSHP-ja do të kthejtarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenëte rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datën 13.06.2025, kemi pranuar vendimin nga AK-së, që jemi eliminuar nga aktiviteti i prokurimit.
Në aktivitetin e Prokurimit me titull: Blerja e doneve për dy parqet kombëtare, Parku Kombëtar Bjeshkët e Nemuna dhe Sharri, është shpallur fitues GOE: **INFINIT SHPK dhe Ndërmarjta Tregtare Grafike Blendi O.P.**, me vlerë të ofertës:8,440.00€

OE GJEO-PROJEKT SHPK, për këtë aktivitet prokurimi ka ofertuar me cmimi prej:7,000.00€.

Pretendimi 1:Në lidhje me vendimin për eliminimin e Operatorit Ekonomik tonë nga procedura e prokurimit, dëshirojmë të theksojmë se arsyetimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktues nuk është i mbështetur në dokumentet e tenderit dhe përfaqëson një devijim të qartë nga kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit (DT). Sipas Dëshmisë 2 të DT-së, është kërkuar që të dorëzohet specifikacioni i detajuar për dronin e ofruar, në formë broshure ose përmes një linku nga uebfaqja e internetit, apo specifikacion teknik nga uebfaqja. Në përputhje me këtë kërkesë, në ofertën tonë kemi paraqitur linkun zyrtar të prodhuesit DJI për specifikimet teknike të modelit të kërkuar DJI Mavic 3 Pro (https://www.dji.com/global/mavic-3-pro/specs), si dhe linkun zyrtar për kontrolluesin DJI RC (https://www.dji.com/global/rc/specs). Përveç kësaj, kemi dorëzuar edhe një broshurë të përgatitur mbi bazën e këtyre faqeve zyrtare dhe fotografin e setit. Prandaj, konsiderojmë se kemi përmbushur në tërësi kërkesën e Dëshmisë 2. Elimini ynë me arsyetimin se mungon përshkrimi i përmbajtjes së kutisë është i pabazuar, pasi një kërkesë e tillë nuk është e përcaktuar në asnjë pjesë të DT-së. Për më tepër, vetë prodhuesi DJI, në faqet e tij zyrtare, ofron pamje vizuale për përmbajtjen e kutisë, pa një përshkrim të detajuar të çdo komponenti, dhe kjo është praktikë standarde e industrisë. Rrjedhimisht, kjo nuk mund të konsiderohet si mungesë nga ana jonë. Në përputhje me nenin 7 dhe nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, kërkojmë që vendimi për eliminim të rishqyrtohet, dhe oferta jonë të pranohet për rivlerësim të mëtejshëm, pasi është në përputhje të plotë me kërkesat e dokumentacionit të tenderit.

Pretendimi 2: Përtej linqeve zyrtare të dorëzuara nga faqja e prodhuesit DJI, me qëllim të lehtësimit të vlerësimit të ofertës nga Autoriteti Kontraktues, kemi bashkëngjitur edhe dokumentin me titull **"14. Specifikat e Dronit DJI Mavic 3 Pro dhe DJI RC"**, i cili përmban një përmbledhje të plotë teknike në format tekstual dhe vizual. Në faqen e parë të këtij dokumenti paraqitet **pamja vizuale e dronit** dhe **përmbajtja e setit**, ndërsa në vijim përfshihen **15 faqe me përshkrime të detajuara teknike** për secilin nga komponentët që përbëjnë setin e pajisjes, përfshirë edhe specifikimet teknike të kontrolluesit DJI RC. Kjo broshurë është ndërtuar mbi bazën e të dhënave zyrtare të prodhuesit dhe përmbush në tërësi kriteret e përcaktuara në Dëshminë 2 të DT-së. Duke marrë parasysh që oferta jonë përfshin **si burime zyrtare (linke)**, ashtu edhe **material mbështetës të strukturuar me përmbajtje tekstuale dhe vizuale**, konstatojmë se arsyeja e eliminimit të OE **GJEO-PROJEKT SHPK** është e pabazuar dhe në kundërshtim me kërkesat reale të dokumentacionit të tenderit.



Pretendimi 3: Pas qasjes në dokumentacionin zyrtar dhe analizimit të ofertës së **GOE-së së rekomanduar për kontratë**, kemi konstatuar shkelje të qarta dhe mungesë përmbushjeje të **Kërkesës dhe Dështmisë 4**, ashtu siç janë të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Konkretisht, GOE ka paraqitur si menaxher të projektit z. **Labinot Zenel Dujaka**, i cili, sipas dokumentacionit të dorëzuar, ka të përfunduara studimet Bachelor në programin **"Bachelor i Arteve në Menaxhment dhe Informatikë"**. Ky program nuk përkon me kërkesën specifike të DT-së, që kërkon diplomë në **shkenca kompjuterike**, dhe për rrjedhojë nuk e përmbush kriterin profesional të kualifikimit.

Për më tepër, në dosjen e ofertës **mungon vendimi për caktimin e menaxherit të projektit**, që është një nga dështmitë e kërkuara qartë në **Dështminë 4**. Mungesa e vendimit për caktim dhe mospërputhja e fushës së diplomës me kërkesën e DT-së përbëjnë **shkelje të drejtpërdrejta të kritereve të përcaktuara**, të cilat duhet të çonin në **skualifikimin e menjëhershëm** të ofertës së GOE. Rrjedhimisht, vendimi i Autoritetit Kontraktues për ta rekomanduar këtë operator për kontratë është i pabazuar dhe cenon parimin e barazisë në trajtimin e ofertuesve.

Pretendimi 4: Sipas dokumentacionit të ofertës së **Grupit të Operatorëve Ekonomikë të rekomanduar për kontratë**, konstatohet se **kompania lider – Infinit SHPK nuk posedon certifikatën ISO 27001**, e cila është kërkuar shprehimisht në **Kërkesën 3 dhe Dështminë përkatëse në DT**. Kjo përbën shkelje të drejtpërdrejtë të **nenit 26.6 të Rregullores për Prokurim Publik (versioni i konsoliduar)**, e cila përcakton qartë se **çdo anëtar i grupit të OE-ve duhet të përmbushë individualisht kriteret që janë të lidhura me kualifikimin profesional dhe tekniko-organizativ**, përfshirë edhe posedimin e standardeve ISO të kërkuara në tender. Mosplotësimi i këtij kriteri nga kompania lider – që është përgjegjëse për zbatimin e kontratës – e bën ofertën të papranueshme dhe duhej të çonte në **skualifikim të menjëhershëm**, në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe rregullat e zbatueshme për grupet e operatorëve ekonomikë.

Pretendimi 5: Nga analiza e dokumentacionit të dorëzuar nga Grup-Operatori Ekonomik, është evidentuar se broshurat e prezantuara nga ana e tyre nuk përmbushin kërkesat minimale të specifikimeve teknike për komplet setin e dronit. Konkretisht, nuk janë dhënë specifika teknike për komponentë të rëndësishëm si **mbushësi i baterisë DJI 100W USB-C Power Adapter, kablli USB-C Cable Adapter, kontrolleri DJI RC**, dhe aksesorë të tjerë thelbësorë të përbërjes së setit.

Në broshurën e tyre përfshihet vetëm një fotografi e përgjithshme dhe katër faqe me specifika të pjesshme dhe të paplota, duke rezultuar në një mungesë të qartë të informacioneve teknike të detajuara. Ndërkohë, ne kemi ofruar një dokumentacion të plotë dhe të detajuar me **15 faqe specifikimesh teknike**, së bashku me fotografi përkatëse, që përmbushin në mënyrë të plotë kërkesat e tenderit. Në këtë kontekst, konsiderojmë të padrejtë dhe të paarsyeshme trajtimin e ofertës sonë si të papërgjegjshme, ndërsa ofertës së Grup-Operatorit Ekonomik me dokumentacion të mangët t'i lejohet vazhdimi i garës, duke cenuar kështu parimin e barazisë dhe transparencës në procesin e prokurimit.



Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet të cilat u cekën më lartë, kërkojmë nga ju që të nxjerri:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **GJEO-PROJEKT SHPK**
ANULOHET njoftimi mbi vendimin i AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, ankesës në vlerë prej 1,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP,Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*